



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK



Oda e infermierëve, mameve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës

Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova

The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Në bazë të nenit 9.1.8, nenit 21 dhe nenit 39 të Ligjit për Odën e Profesionistëve Shëndetësor ,nenit 14.1.7 dhe nenit 26 të statutit të OIK-ut ,Këshilli Drejtues i OIK-ut në mbledhjen e vete të mbajtur me datën 02.05.2019 shqyrtoi vendimin e K. Drejtues të datës 22.05.2018 me Nr.Prot. 168/2 të datës 06.06.2018 dhe nxori këtë.

VENDIM

Vendim për lartësinë e taksave për akreditim të programeve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

I. Me këtë vendim, në pajtim me rregulloren e OIK-ut për EVP përcaktohen obligimet e organizatave , shoqatave profesionale ,shkencore dhe edukative të cilat ofrojnë programe të EVP-së për procedurat e aplikimit , lartësinë e taksës, afatet për aplikim dhe akreditim , monitorimi i programeve , raportimi dhe dispozitat kalimtarë .

II. Të gjitha subjektet nga neni paraprak i këtij vendimi që nuk e shfrytëzojnë përkrahjen financiare nga OIK-u, institucionet publike dhe programet apo projektet në formë donacionit (pjesëmarrës pa kuotizim) obligohen që të kompensojnë taksën për akreditim dhe zhvillim te programeve në lartësinë prej :

- **Për aplikim konference, kongrese, trajnime , seminare vendore (20 euro) ndërsa për ndërkombëtare (30 euro)**
(Akreditimi)
- Për zhvillim të programeve sipas kritereve si në vijim :

| Nr. i pjesëmarrësve | Pagesa |
|---------------------|---------------------------------------|
| 01-100 | 120 € |
| 101-250 | 300 € |
| 251-500 | 600 € |
| 501-700 | 900 € |
| Mbi*700 | Për çdo pjesëmarrës nga 1.50 € shtesë |

III. Te gjitha institucionet qe gëzojnë përkrahje financiare nga OIK per zhvillim te programeve te EVP , institucionet dhe organizatat publike si dhe programet ne forme te donacioni dhe perkrahjes perms bashkepunimit institucional lirohen nga pagesa e takses per akreditim dhe takses per zhvillim te programeve .

III.1 Subjektet e liruara nga oligimi i pagesës së takseës nga paragrafi paraprak e këtij vendimi duhet ta dëshmojnë pranë Komisionit të OIK-ut cilësinë-statutin e subjektit .

IV. Subjektet nga pika 1 e këtij vendimi duhet të aplikojë për akreditim se paku 45 ditë nga mbajtja e programit.Komisioni për EVP në afat prej 15 ditë nga dita e aplikimit do të marrë vendim për akreditim/refuzim .

V. Çdo program të akredituar nga OIK monitorohet me qëllim të sigurimit se program i akredituar është zhvilluar sipas agjendës së përcaktuar me vendim për akreditim , pjesëmarrja e ligjëruesve , pjesëmarrja e vijuesve dhe kushtet e nevojshme teknike , hapsinore për zhvillim të programit dhe kohëzgjatje.

V.1. Kryetari i OIK-ut për çdo rast të monitorimit cakton 1 anëtarë nga Komisioni i EVP-së dhe 1 anëtarë tjetër nga Këshilli Mbikqyrës.

V.2. Në afat prej 48 orë pjesëmarrësit e monitorimit do të përegadis reportin me shkrim mbi përbashjen e kritereve të përcaktuara në pikën 5 te këtij vendimi.

V.3. Impementues i programit në afat prej 72 orësh do t'i dorëzoj OIK-ut reportin mbi ecurinë e ndodhisë duke përfshirë të gjitha kriteret nga pika 5. e këtij vendimi, raportit duhet të ju bashkangjitet lista e pjesëmarrësve e përmbyllur dhe e nënshkruar nga monitoruesi.


VI. Në raste të mos përbushjes së kritereve „standard te kerkuara nga subjektet e akredituara, OIK do të merr masa ndëshkuese në varësi nga niveli i shkeljeve të kritereve duke shqiptuar gjoba monetare në lartësinë prej 100-300 euro , masen e ndalimit e mbajtjes EVP-së në periudhën 6-12 muaj dhe në rastet më të rënda duke shqiptuar, masën e ndalimit te perhershëm të akreditimit të programit.

VII. Subjektet e pa kënaqur ndaj vendimeve të komisionit për akreditim dhe ndaj vendimeve për shqitit të masave ndëshkuese kanë të drejtën e ushtrimit të ankesës KD të OIK-ut në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit

VIII. Ky vendim hyn ne fuqi ditën e miratimit ndërsa fillon të zbatuarit nga data 02.05.2019.

Shtojcë e këtij vendimi janë kriteret dhe format e specifikuara për monitorim.

Kryetari i Këshillit Drejtues
Muharrem Arifi



Kryetari i OIK-ut
Naser Rrustemaj

